



12
20.01.2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 45/ Prot.
1

Tiranë, më 20.01. 2017

LËNDA: Përcillet shkresa e MAS lidhur me një njoftim nga Ambasada e Turqisë në Tiranë

DREJTUAR: Sh. Teknologji Informacioni

Gjeni bashkëngjitur shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me anë të së cilës përcillet njoftimi i Ambasadës së Turqisë në Tiranë mbi akordimin nga Republika e Turqisë, të bursave për studime universitare dhe pasuniversitare në Turqi, për studentët e huaj në vitin akademik 2016-2017.

Lutemi të afishohet njoftimi për informacion të personave të interesuar.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

Rektori
Prof. Dr. Andrea MALIQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi "Nene Tereza", Nr.4, Tirane,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al

KOLEGJIT PROFESIONAL PRIVAT "IVOCLAR VIVADENT &
PARTNERS"
RRUGA "PROKOP MYZEQARI", P/90/1
TIRANË


Të nderuar rektorë,


Në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nga Ambasada e Republikës së Turqisë në Tiranë, është depozituar shkresa, nëpërmjet së cilës përcillet njoftimi mbi akordimin, nga Republika e Turqisë, e bursave për studime universitare dhe pasuniversitare në Turqi, për studentët e huaj, për vitin akademik 2016-2017.

Lutemi, gjeni bashkëlidhur shkresën e sipërcituar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PLARENT NDRECA


SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



Përkthim jozyrtar

2016/95256038/11696284

Tepër urgjent

Ambasada e Republikës së Turqisë në Tiranë i paraqet komplimentet e saj Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe ka nderin të njoftojë se Republika e Turqisë ka siguruar mundësinë për t'u akorduar studentëve të huaj bursa për studime universitare dhe pasuniversitare në Turqi për vitin akademik 2016-2017.

Të dhënat e përgjithshme dhe kushtet për bursat mund të gjenden online në adresën www.turkiyeburslari.gov.tr. Megjithëse datat për fillimin e aplikimeve do të shpallen më vonë, parashikohet që aplikimet për të fituar bursë për master dhe doktoraturë të fillojnë në fund të dhjetorit, ndërsa për bursat për bachelor në një datë të mëvonshme.

Ambasada i lutet Ministrisë së Nderuar që të përcillen në institucionet arsimore shqiptare të interesuara informacioni i sipërpermendur dhe adresa www.turkiyeburslari.gov.tr.

Ambasada e Republikës së Turqisë në Tiranë përfiton nga rasti t'i përsërisë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë sigurimet e konsideratës së saj më të lartë.

Tiranë, më 9 dhjetor 2016

Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë

Për dije: Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë